

Metoda katër-shkallëshe	Metoda e përpunimit të mësimit praktik
<p>1. Përgatitja dhe motivimi i nxënësit</p> <ul style="list-style-type: none"> - Parakushtet për mësime, ndër tjera përcaktimi i njohurive dhe përvojës - Zgjidhja e interesimit dhe motivimi - Këshilla lidhur me qëllimet dhe detyrat - Njohja me vendin e punës, me ndërrmarje të masave të informohen mbi parandalimin e lëndimeve 	<p>1. Faza përgatitore</p> <ul style="list-style-type: none"> - Dhënia e detyrës dhe ndërlidhja e saj me shkollimin (çka është përpunuar më parë dhe çka vie më pas) - Të pyetet domethënia për punë dhe për ndërrmarje, në rast nevojë dhënia e këshillave lidhur me detyrën - Përcaktimi i njohurive dhe përvojave paraprake (p.sh. vrojtimit në situatat konkrete të punës), nëse është nevojë të shikohet vërtetimi lidhur me shkollimin e ndërlidhur me punën konkrete - Këshillimi lidhur me rreziqet e lëndimit respektivisht ndërmjetësimi i tyre bashkë me nxënësit
<p>2. Demonstrimi dhe sqarimi</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nxënësi duhet të qëndrojë në drejtim të njëjtë sikurse mësimeve të mëparshmeve - Të demonstron procesin në tempo origjinale dhe në lidhshmëri - Rastet e komplikuar të punës të ndahen në pjesë dhe të demonstron njëra pas tjetrës - Përsëritje e demonstrimit me heqje (shkarkim) të artit të hapave të veçantë të punës me një tempo më të ngadalsuar - Gjatë sqarimit të hapave të punës të definohen pikat kyçe - Dhënia e mundësisë që nxënësi të prashtojë pyetje 	<p>2. Faza e përpunimit</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pozicionimi i drejtë i nxënësit për të zhvilluar punën - Të pyetet nxënësi lidhur me ecurinë e punës dhe të kërkohen sqarime (si mund të veprojmë? Pse mu në këtë mënyrë?); gjatë kësaj kohe duhet bashkarisht të përpunohen masat për parandalimin e fatkeqësive - Në disa hapa të punës ti lejohet nxënësit të tentojë punë të pavarur - Me rëndësi: Tek veprimet e rrezikshme të jipen udhëzime të qarta ose të demonstron hapa të ndryshëm të punës - Nëse është nevojë të jipen këshilla korigjuese, por kryesisht nxënësi të lihet të punojë i pavarur
<p>3. Të lejohen përpjekjet për realizim</p> <ul style="list-style-type: none"> - Metoda e përpunimit të mësimit praktik - Inkurajimi i nxënësit për përpjekje vetanake - Gjatë përpjekjeve të para nxënësi nuk duhet ndërprerë përmes ndonjë kritike apo korigjimi, në mënyrë që të mos dekurajohet - Të udhëzohet mbi gabimet e përgjithshme - Të mos lejohet punë tepër e shpejtë; Saktësia në punë ka përparësi ndaj shpejtësisë - Të lejohet nxënësi që me fjalët e veta të sqarojë se pse dhe si është duke kryer diçka 	<p>3. Faza e kontrollimit</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nxënësit ti lejohet vetëvlerësimi i punës së tij, nëse nevojitet të përpunohen bashkarisht kriteret e vlerësimit apo pjesërisht të paracaktohen - Të lejohet përmbledhja e pikave kyçe thelbësore nga ana e nxënësit - Në rast nevojë të prashtrohen pyetje shtesë për të kuptuar lidhshmëritë
<p>4. Të ushtruarit dhe forcimi</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të ofrohen mundësi të bollshme për ushtrime - Përparimet në ushtrime të kontrollohen dhe të pranohen - Të kihet kujdes që të mos vjen deri tek përvjedhja e gabimeve gjatë ushtrimeve - Variabiliteti i kushteve të ushtrimeve - Përshtatja graduale në kushte reale të punës (p.sh. Shpejtësia) 	<p>4. Faza e ushtrimit</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pas përfundimit të mësimeve praktike, nxënësit ti prashtrohen detyra në formë të ushtrimeve konkrete; me këtë rast duhet të ndryshojnë kushtet e ushtrimeve - Të analizohen rezultatet e ushtrimeve dhe të kihet kujdes që të mos ngulitet ndonjë gabim - Nxënësit ti jipet mundësia e aplikimit të të mësuarit të ndonjë porosie



A i keni dalluar ndryshimet në mes të metodës katër-shkallëshe dhe asaj të përpunimit?

Që të dy metodat nisen prej hapave të njëpasnjëshëm të punës praktike. Në kuadër të katër hapave të lartpërmendur të metodës së përpunimit vërehet qartë se nxënësi fillon punë të pavarur që nga faza e dytë.

Në shkallën e tretë, nxënësit e vlerësojnë vetë punën e tyre.

Metoda e përpunimit është para së gjithash e mirë, në rastet kur nxënësi tanimë ka njohuri paraprake dhe shkathtësi, d.m.th. në pjesën e dytë të shkollimit.